UDHËZIM
Nr. 644, datë 2.9.2026

PËR PROCEDURËN E KONTROLLIT MJEKËSOR PËR PAJISJEN ME LEJE DREJTIMI TË MJETEVE ME MOTOR, ADMINISTRIMIN DHE SHKËMBIMIN ELEKTRONIK TË DOKUMENTACIONIT PËRKATËS

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 40, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 43/2023, "Për qeverisjen elektronike", të ndryshuar; të ligjit nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe të VKM-së nr. 153, datë 7.4.2000, "Për miratimin e rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,

UDHËZON:

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurës së kontrollit mjekësor, referimit, vlerësimit të specializuar, dokumentimit, administrimit, shkëmbimit elektronik të formularëve dhe të dhënave që përmbahen në to për kontrollin mjekësor për personat që aplikojnë për pajisjen ose rinovimin e lejes së drejtimit të mjeteve me motor, si dhe për mbajtësit e lejes së drejtimit që i nënshtrohen vlerësimit mjekësor për verifikim të aftësive psikofizike në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Institucionet shëndetësore publike që kryejnë procedurat e kontrollit mjekësor sipas këtij udhëzimi përdorin formularët mjekësorë model IV.1, IV.4, IV.5 dhe IV.6, të miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në vijim referuar si "Rregullorja për zbatimin e Kodit Rrugor". Formularët mjekësorë elektronikë përbëjnë versionin elektronik të këtyre formularëve. Digjitalizimi i tyre nuk sjell ndryshime në përmbajtjen, strukturën dhe elementet e detyrueshme, por vetëm në mënyrën e plotësimit, nënshkrimit, administrimit, aksesimit dhe shkëmbimit të tyre nëpërmjet sistemeve elektronike.

Neni 2

Fillimi i procedurës

1. Aplikanti paraqitet pranë institucionit shëndetësor publik kompetent për kryerjen e kontrollit mjekësor dhe fillimin e procedurës së vlerësimit për pajisjen me leje drejtimi të mjetit me motor.

2. Pas identifikimit të aplikantit dhe verifikimit të pagesës përkatëse, mjeku i përgjithshëm/mjeku i familjes fillon procedurën e vlerësimit mjekësor.

Neni 3

Vlerësimi fillestar, referimi i aplikantit dhe plotësimi i formularit model IV.4

1. Pas paraqitjes së aplikantit sipas nenit 2, të këtij udhëzimi, mjeku i përgjithshëm/mjeku i familjes, e identifikon atë dhe shqyrton kartelën mjekësore fizike dhe/ose elektronike, rezultatet e ekzaminimeve bazë mjekësore dhe dokumentacionin tjetër shëndetësor të disponueshëm, të nevojshëm për vlerësimin e aplikantit. Gjatë vlerësimit, mjeku dallon gjendjet shëndetësore aktuale nga gjendjet e kaluara dhe të shëruara, si dhe nga diagnozat e dyshuara që nuk janë konfirmuar me ekzaminime ose konsultë të specializuar.

2. Kur në kartelën mjekësore nuk gjenden të dhëna të mjaftueshme për vlerësimin e një rubrike të Certifikatës së Anamnezës, mjeku kërkon sipas rastit dokumentacion shëndetësor shtesë të paraqitur nga aplikanti dhe/ose kryen referimin për vlerësim të mëtejshëm. Mungesa e të dhënave në kartelën elektronike nuk konsiderohet në vetvete as provë e mungesës së sëmundjes dhe as provë e ekzistencës së saj.

3. Për rubrikat që lidhen me shëndetin mendor dhe përdorimin e substancave psikoaktive, kur kjo është e nevojshme për vlerësimin e aftësisë psikofizike, mund të kërkohet verifikim i të dhënave në strukturat shëndetësore publike kompetente që disponojnë historik të dokumentuar trajtimi, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe shëndetësore.

4. Pas plotësimit dhe nënshkrimit elektronik të formularit “Certifikatë Anamneze” model IV.4, mjeku i përgjithshëm/i familjes e referon aplikantin pranë mjekëve specialistë për shikimin dhe për dëgjimin.

5. Kur konstaton shkaqe për referimin e aplikantit pranë Komisionit Mjekësor, mjeku i përgjithshëm/i familjes vepron sipas nenit 5 të këtij udhëzimi.

Neni 4

Vlerësimi nga mjekët specialistë dhe plotësimi i formularit model IV.5

1. Pas referimit nga mjeku i përgjithshëm/i familjes dhe kryerjes së pagesave përkatëse, aplikanti paraqitet fizikisht me dokument identifikimi të vlefshëm, pranë mjekëve specialistë të shikimit dhe dëgjimit.

2. Secili mjek specialist identifikon aplikantin, shqyrton formularin elektronik "Certifikatë Anamneze" model IV.4 dhe kryen vlerësimin mjekësor sipas specialitetit përkatës.

3. Pas kryerjes së vlerësimit, secili mjek specialist plotëson fushat që i përkasin specialitetit të tij në formularin elektronik "Certifikatë mjekësore" model IV.5 dhe i nënshkruan ato elektronikisht.

4. Kur konstaton se aftësia e aplikantit për drejtimin e mjetit kushtëzohet nga kufizime që lidhen me specialitetin e tij, mjeku specialist regjistron në formularin "Certifikatë mjekësore" model IV.5 kodin përkatës të kufizimit sipas nenit 292 të Rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor.

5. Formulari "Certifikatë mjekësore" model IV.5 konsiderohet i plotësuar pasi mjekët specialistë të shikimit dhe dëgjimit kanë plotësuar dhe nënshkruar elektronikisht fushat përkatëse.

6. Kur konstaton shkaqe për referimin e aplikantit pranë Komisionit Mjekësor, mjeku specialist përkatës vepron sipas nenit 5 të këtij udhëzimi.

Neni 5

Referimi pranë Komisionit Mjekësor

1. Aplikanti referohet pranë Komisionit Mjekësor, kur:

a) gjatë marrjes së anamnezës ose kryerjes së vlerësimit mjekësor, mjeku i përgjithshëm/i familjes ose mjeku specialist konstaton gjendje shëndetësore që kërkojnë vlerësim të specializuar;

b) rezultatet e kontrolleve ose të ekzaminimeve krijojnë dyshime të arsyeshme për aftësinë psikofizike të aplikantit për drejtimin e mjetit me motor;

c) vlerësimi nga Komisioni Mjekësor kërkohet shprehimisht nga Kodi Rrugor, rregullorja për zbatimin e tij ose legjislacioni tjetër në fuqi.

2. Referimi kryhet nëpërmjet sistemit elektronik dhe përmban:

a) të dhënat identifikuese të aplikantit;

b) arsyen e referimit;

c) mjekun dhe institucionin shëndetësor që kryen referimin;

ç) datën dhe orën e referimit;

d) formularin "Certifikatë anamneze" model IV.4, kur është plotësuar;

dh) formularin "Certifikatë mjekësore" model IV.5, kur është plotësuar;

e) dokumentacionin dhe rezultatet e ekzaminimeve mjekësore që lidhen me arsyen e referimit.

3. Pas regjistrimit të referimit, aplikanti njoftohet për procedurën që duhet të ndjekë, si dhe, sipas rastit, për datën, orën dhe vendin e paraqitjes pranë Komisionit Mjekësor për kryerjen e vlerësimit mjekësor të specializuar.

Neni 6

Vlerësimi nga Komisioni Mjekësor dhe plotësimi i formularit model IV.6

1. Pas referimit, aplikanti paraqitet fizikisht pranë Komisionit Mjekësor, i pajisur me dokument identifikimi të vlefshëm, për kryerjen e vlerësimit mjekësor të specializuar.

2. Krijimi, përbërja dhe funksionimi i Komisionit Mjekësor rregullohen nga rregullorja për zbatimin e Kodit Rrugor. Përbërja e Komisionit dhe anëtarët pjesëmarrës në vlerësimin e aplikantit regjistrohen në sistemin elektronik.

3. Në rastet e parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 117 të Kodit Rrugor, në komision merr pjesë edhe inxhinieri mekanik, specialist i Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Pjesëmarrja dhe vlerësimi i tij regjistrohen në sistemin elektronik.

4. Komisioni Mjekësor identifikon aplikantin dhe konsulton arsyen e referimit, dokumentacionin mjekësor, formularin elektronik “Certifikatë anamneze” model IV.4 dhe formularin elektronik “Certifikatë mjekësore” model IV.5, kur këta formularë janë plotësuar.

5. Komisioni Mjekësor kryen vlerësimin mjekësor të specializuar dhe, kur është e nevojshme për marrjen e vendimit, kërkon ekzaminime apo vlerësime plotësuese, si dhe asistencë nga këshilltarë të veçantë ose institucione mjekësore të specializuara publike, sipas përcaktimeve të rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor.

6. Vendimi i Komisionit Mjekësor merret me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës. Në rast të ndarjes së barabartë të votave, mbizotëron vota e kryetarit. Përbërja e Komisionit, vendimi dhe mënyra e miratimit të tij regjistrohen në sistemin elektronik.

7. Pas përfundimit të vlerësimit, Komisioni Mjekësor plotëson formularin elektronik “Certifikatë mjekësore” model IV.6, në të cilin përcakton:

a) kategorinë ose kategoritë e lejes së drejtimit për të cilat është kryer vlerësimi;

b) grupin ku bën pjesë aplikanti – Grupi 1 ose Grupi 2 – sipas nenit 302 të rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor;

c) afatin e vlefshmërisë së vlerësimit mjekësor;

d) kufizimet përkatëse, kur ka;

e) kufizimin e periudhës së vlefshmërisë së lejes së drejtimit, kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi;

f) rezultatin përfundimtar të vlerësimit:

i. “I aftë për të drejtuar mjet”;

ii. “I aftë për të drejtuar mjet me kufizime”;

iii. “I paaftë për të drejtuar mjet”.

8. Në përcaktimin e rezultatit përfundimtar dhe të afatit të vlefshmërisë së vlerësimit mjekësor, Komisioni Mjekësor merr në konsideratë gjendjen shëndetësore aktuale dhe ndikimin e dokumentuar të saj në aftësinë psikofizike për drejtimin e mjetit; historiku i një sëmundjeje të kaluar dhe të shëruar nuk sjell automatikisht kufizim të afatit. Në rastin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni, mënyra e dokumentimit dhe e nënshkrimit elektronik të vlerësimit të inxhinierit mekanik përcaktohet në manualin teknik, sipas nenit 15 të këtij udhëzimi.

Neni 7

Vlerësimi nga Komisioni Mjekësor dhe plotësimi i formularit model IV.1

1. Me kërkesë të drejtuesit të mjetit, mbajtës i një lejedrejtimi të vlefshme, kur kërkohet konfirmimi i vlefshmërisë së saj në rastet e parashikuara në shkronjat “b” deri në “dh”, të pikës 6, të nenit 117 dhe në paragrafin e dytë, të pikës 1, të nenit 124, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Mjekësor kryen vlerësimin mjekësor të specializuar për lëshimin e “Dëshmisë së aftësisë psikofizike” model IV.1.

2. Për identifikimin e drejtuesit të mjetit, konsultimin e dokumentacionit, kryerjen e vlerësimit dhe vendimmarrjen zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, përcaktimet e nenit 6 të këtij udhëzimi.

3. Pas kryerjes së vlerësimit mjekësor të specializuar, Komisioni Mjekësor plotëson, nënshkruan elektronikisht dhe lëshon formularin model IV.1.

4. Në dëshmi përcaktohet nëse drejtuesi i mjetit plotëson kërkesat fizike dhe psikike për drejtimin e mjeteve të kategorive që zotëron.

5. Dëshmia lëshohet me afatin e vlefshmërisë sipas përcaktimeve të nenit 291 të rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor, në çdo rast jo më shumë se 1 (një) vit.

Neni 8

Aksesimi dhe shkëmbimi elektronik i të dhënave

1. Me përfundimin e procedurës së vlerësimit mjekësor, formularët elektronikë të kontrollit mjekësor për drejtues mjeti me motor, të dhënat që përmbajnë dhe rezultatet e vlerësimit mjekësor i vihen në dispozicion Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) nëpërmjet sistemeve të ndërveprimit. Dokumenti elektronik përfundimtar i dërgohet qytetarit nëpërmjet platformës qeveritare "*e-Albania*".

2. Ndërveprimi elektronik me DPSHTRR-në përfshin vënien në dispozicion, aksesimin dhe shkëmbimin e formularëve elektronikë, të të dhënave dhe të rezultateve të nevojshme për verifikimin e aftësive psikofizike, si dhe për ushtrimin e kompetencave ligjore të DPSHTRR-së në proceset e pajisjes, rinovimit dhe administrimit të lejeve të drejtimit, dëshmive dhe certifikatave të aftësisë profesionale.

3. Të dhënat që vihen në dispozicion, aksesohen, shkëmbehen, ose përcaktohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe nevojat funksionale të ndërveprimit, dhe kufizohen në të dhënat e nevojshme për vlerësimin dhe verifikimin e aftësisë psikofizike për drejtimin e mjeteve me motor.

4. Vënia në dispozicion, aksesimi dhe shkëmbimi elektronik i formularëve, i të dhënave dhe i rezultateve kryhen vetëm nga strukturat dhe personat e autorizuar, për ushtrimin e kompetencave ligjore të institucioneve përkatëse dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë udhëzim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, qeverisjen elektronike dhe sigurinë e sistemeve të informacionit.

Neni 9

Kërkesat për sistemet elektronike

1. Zhvillimi, integrimi dhe ndërveprimi i sistemeve elektronike të nevojshme për zbatimin e këtij udhëzimi kryhen në koordinim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në përputhje me legjislacionin në fuqi për qeverisjen elektronike dhe sipas kompetencave të institucioneve përgjegjëse.

2. Komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet sistemeve elektronike të sektorit shëndetësor dhe sistemeve të DPSHTRR-së kryhen nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe legjislacionin në fuqi.

3. Formularët dhe dokumentet elektronike nënshkruhen elektronikisht nga personat përgjegjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Afati i vlefshmërisë

1. Formularët elektronik dhe dokumentacioni mjekësor i krijuar sipas këtij udhëzimi janë të vlefshëm brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Afati i vlefshmërisë së vlerësimit mjekësor llogaritet nga data e lëshimit të formularit përfundimtar me të cilin përfundon procedura e vlerësimit, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon ndryshe.

Neni 11
Mbrojtja e të dhënave personale

1. Përpunimi, aksesimi dhe shkëmbimi i të dhënave personale dhe shëndetësore që përmbajnë formularët elektronikë model IV.1, IV.4, IV.5 dhe IV.6 kryhen vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë udhëzim dhe kufizohet në të dhënat e nevojshme për ushtrimin e kompetencave ligjore të institucioneve përkatëse.
2. Institucionet pjesëmarrëse marrin masat teknike dhe organizative të nevojshme për garantimin e konfidencialitetit, integritetit, sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12
Tarifat e kontrollit mjekësor

1. Tarifat për kryerjen e kontrolleve mjekësore sipas këtij udhëzimi zbatohen në përputhje me aktet në fuqi për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimeve shëndetësore publike.
2. Institucionet shëndetësore publike zbatojnë tarifat e miratuara dhe i afishojnë ato në mënyrë të dukshme dhe të aksesueshme për qytetarët. Për zbatimin e kësaj pike përgjigjen drejtuesit e institucioneve shëndetësore publike përkatëse.

Neni 13
Ruajtja dhe arkivimi

1. Dokumentacioni i krijuar në kuadër të këtij procesi ruhet, arkivohet dhe administrohet në formë elektronike në sistemet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Institucionet shëndetësore përgjegjëse sigurojnë aksesin dhe administrimin e dokumentacionit sipas kompetencave përkatëse.

Neni 14
Raportimi vjetor

1. Brenda muajit shkurt të çdo viti, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë raportin vjetor mbi veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit pararendës në zbatim të këtij udhëzimi.
2. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë vë në dispozicion të ministrisë përgjegjëse për transportin të dhënat statistikore të nevojshme për ushtrimin e kompetencave të saj.
3. Të dhënat e raportuara përmbajnë vetëm të dhëna statistikore dhe të agreguara, pa të dhëna personale që mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejt ose të tërthortë të qytetarëve.

Neni 15
Manuali teknik

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton dhe miraton manualin teknik, i cili përcakton mënyrën e plotësimit, nënshkrimit, administrimit dhe shkëmbimit elektronik të formularëve.

Neni 16
Zbatimi për dokumente dhe procese të tjera

1. Përcaktimet e këtij udhëzimi për administrimin, aksesimin dhe shkëmbimin elektronik të formularëve dhe të dhënave zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, edhe për dokumente, formularë ose të dhëna të tjera mjekësore që lidhen me vlerësimin ose verifikimin e aftësisë psikofizike për drejtimin e mjeteve me motor, kur administrimi ose shkëmbimi i tyre është i nevojshëm për ushtrimin e kompetencave ligjore të DPSHTRR-së në fushën e lejeve të drejtimit dhe lëshimit të dokumenteve të aftësisë profesionale për drejtuesit e mjeteve.

Neni 17
Dispozitë kalimtare

1. Deri në vënien në funksion të sistemeve elektronike dhe shërbimeve të ndërveprimit ndërinstitucional të parashikuara në këtë udhëzim, procedurat e kontrollit mjekësor për personat që aplikojnë për leje drejtimi të mjetit me motor kryhen sipas udhëzimit nr. 205, datë 7.5.2015, “Mbi plotësimin e formularit të kontrollit mjekësor për persona që aplikojnë për leje drejtimi të mjetit me motor”.

2. Data e fillimit të zbatimit të procedurës elektronike përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, pas konfirmimit të gatishmërisë së sistemeve elektronike dhe të shërbimeve të ndërveprimit ndërinstitucional.

3. Me fillimin e zbatimit të procedurës elektronike sipas pikës 2 të këtij neni, udhëzimi nr. 205, datë 7.5.2015, vazhdon të zbatohet vetëm për institucionet që ende nuk janë përfshirë në sistemin elektronik.

Neni 18

Zbatimi

1. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe institucionet e kujdesit shëndetësor publik në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e këtij udhëzimi, në përputhje me kompetencat e tyre.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala